KOMUNA RAHOVEC/OPSTINA ORAHOVAC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 229 Nr. i faq/Br.str/No.pg 117
Data/Datum/Date 1 / 3 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

# Republika e Kosovës

*Komuna e Rahovecit*

**Kabineti i Kryetarit**

---

## LISTA E VENDIMEVE NGA KRYETARI I KOMUNËS SË RAHOVECIT, Z. SMAJL LATIFI: SHKURT 2023

| Nr | Emri i vendimit | Nr. Protokollit |
|---|---|---|
| 1 | Vendim për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave dhe të propozimeve për Planin Zhvillimor Komunal 2023-2031 | Nrp-02-101-2023 |
| 2 | Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës | NRP-02-102-2023 |
| 3 | Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës | NRP-02-103-2023 |
| 4 | Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës | NRP-02-104-2023 |
| 5 | Vendim për caktimin e komisonit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve | NRP-02-107-2023 |
| 6 | Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave | NRP-02-109-2023 |
| 7 | Vendim për lirimin nga pozita e zyrtarit administrative në Kabinetin e Kryetarit të Komunës së Rahovecit dhe këshilltar për kategoritë e dala nga lufta e Ushtrisë Clirimtare të Kosovës | NRP-02-112-2023 |
| 8 | Vendim për formimin e komisionit komunal të regjistrimit | NRP-02-114-2023 |
| 9 | Vendim për kompensimin e punës shtesë jashtë orarit të rregullt të punës për muajin janar 2023 | NRP-02-117-2023 |
| 10 | Vendim për kompensimin e punës shtesë jashtë orarit të rregullt të punës për muajin janar 2023 | NRP-02-118-2023 |
| 11 | Vendim miratohet kërkesa e [illegible] nga Rahoveci | NRP-02-119-2023 |
| 12 | Vendim për lejimin e udhëtimit zyrtar | NRP-127-2023 |
| 13 | Vendim për lejimin e udhëtimit zyrtar | NRP-02-128-2023 |
| 14 | Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës | NRP-02-129-2023 |
| 15 | Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave | NRP-02-132-2023 |
| 16 | Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave | NRP-02-137-2023 |
| 17 | Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave | NRP-02-136-2023 |
| 18 | Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave | NRP-02-145-2023 |
| 19 | Vendim për cakimin e komisionit për vlerësimin e komisionit për vlerësimin e pronës komunale për këmbim | NRP-02-144-2023 |
| 20 | Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave | NRP-02-146-2023 |
| 21 | Vendim për caktimin e komisionit për verifikimin e gjendjes faktike, vlerësimin e aseteve dhe të objektit | NRP-02-148-2023 |
| 22 | Vendim për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve për ndihma momentale 2023 | NRP-02-147-2023 |

| | | |
|---|---|---|
| 23 | Vendim miratohet kërkesa e [redacted] | NRP-02-149-2023 |
| 24 | Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave | NRP-02-157-2023 |
| 25 | Vendim për caktimin e komisionit për ndarjen e Titullit të Nderit "Medalja e Lirisë" | NRP-02-158-2023 |
| 26 | Vendim-aprovohet kërkesa me Nr. 481, e datës 13.2.2023 | NRP-02-159-2023 |
| 27 | Vendim për ekzekutimin e mjeteve financiare | NRP-02-160-2023 |
| 28 | Vendim për ekzekutimin e mjeteve financiare | NRP-02-161-2023 |
| 29 | Vendim për ekzekutimin e mjeteve financiare | NRP-02-162-2023 |
| 30 | Vendim për ekzekutimin e mjeteve financiare | NRP-02-163-2023 |
| 31 | Vendim për ekzekutimin e mjeteve financiare | NRP-02-164-2023 |
| 32 | Vendim për lejimin e pagesës shtesë për punë jashtë orarit | NRP-02-165-2023 |
| 33 | Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave | NRP-02-169-2023 |
| 34 | Vendim formohet komisioni për përzgjedhjen e punimeve në artin figurative nga nxënësit e shkollave të komunës së Rahovecit, në kuadër të ekspozitës së 17 shkurtit 2023 | NRP-02-171-2023 |
| 35 | Vendim formohet komisioni për përzgjedhjen e kandidatëve të jashtëm për vlerësimin e project-propozimeve të OJQ-ve | NRP-02-172-2023 |
| 36 | Vendim miratohet kërkesa e [redacted]ataqan i Poshtëm | NRP-02-173-2023 |
| 37 | Vendim miratohet kërkesa e OVL-së | NRP-02-174-2023 |
| 38 | Vendim për caktimin e komisionit Komunal për Vlerësimin e Dëmeve të shkaktuara në të mirat material nga ndikimi I fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera | NRP-02-178-2023 |
| 39 | Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave | NRP-02-184-2023 |
| 40 | Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave | NRP-02-189-2023 |
| 41 | Vendim për dhënien e pushimit të lehonisë, znj. Blerta Gashi | NRP-02-190-2023 |
| 42 | Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave | NRP-02-192-2023 |
| 43 | Vendim miratohet kërkesa e z. [redacted] | NRP-02-193-2023 |
| 44 | Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me Nr. Prot. 02/136/23, I datës 9.2.2023 për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave | NRP-02-194-2023 |
| 45 | Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me Nr. Prot. 02/184/23, I datës 16.2.2023 për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave | NRP-02-195-2023 |
| 46 | Vendim për caktimin e zyrtarit kontaktues për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhënave në komunën e Rahovecit, z. Alban Gashi. | NRP-02-199-2023 |
| 47 | Vendim për [illegible] e shpërblimit të përvjetorit [illegible] Sarenda Shala | [illegible] |
| 48 | Vendim për qasje në dokumente publike | NRP-02-201-2023 |
| 49 | Vendim për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit me nr.145, i datës 9.2.2023 | NRP-02-203-2023 |
| 50 | Vendim për dhënien e pushimit të lehonisë, znj. Elma Shehu | NRP-02-204-2023 |
| 51 | Vendim për caktimin e komisionit për vlerësiimin e dëmeve material dhe financiare në SHFMU "Mustafë Ibishi", paralelja e nadrë në Mrasor | NRP-02-205-2023 |

| | | |
|---|---|---|
| 52 | Vendim miratohet kërkesa [redacted] | NRP-02-206-2023 |
| 53 | Vendim miratohet kërkesa e [redacted] | NRP-02-207-2023 |
| 54 | Vendim miratohet kërkesa e [redacted] | NRP-02-208-2023 |
| 55 | Vendim miratohet kërkesa z. [redacted] | NRP-02-209-2023 |
| 56 | Vendim për caktimin e komisionit për identifikimin pronave të uzurpuara | NRP-02-210-2023 |

| | | |
|---|---|---|
| 57 | Vendim për dhënien e pushimit nga puna pa pagesë | NRP-02-213-2023 |
| 58 | Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e dëmeve material dhe financiare në Palestrën e Sporteve "Mizahir Isma" në Rahovec | NRP-02-214-2023 |
| 59 | Vendim për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të dhe shoqatat në fushën e rinisë dhe sportit mbi bazën e thirrjes publike | NRP-02-215-2023 |
| 60 | Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave | NRP-02-216-2023 |
| 61 | Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave | NRP-02-217-2023 |
| 62 | Vendim për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për ndarjen e subvencioneve për OJQ-te dhe shoqatat në fushën e kultures dhe sportit mbi bazën e thirrjes publike | NRP-02-218-2023 |
| 63 | Vendim miratohet kërkesa e [redacted] | NRP-02-219-2023 |

Rahovec, shkurt 2023

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PRESEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 101 Nr. i faq/Br.str/No.pg 105
Data/Datum/Date 1 / 2 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosoves *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, neneve 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4, i Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**V E N D I M**
**Për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave dhe të propozimeve për Planin Zhvillimor Komunal (PZHK) 2023-2031**

1. **Caktohet** komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave dhe të propozimeve për Planin Zhvillimor Komunal (PZHK) 2023– 2031, në Komunën e Rahovecit, në këtë përbërje:
   **1.1.** Shpejtim Mustafa– Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, kryesues
   **1.2.** Arsim Kastrati– Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar
   **1.3.** Sylejman Daka– Drejtoria për Shërbime Publike, anëtar
   **1.4.** Vlora Nazifi- Gashi– Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, anëtare
   **1.5.** Fidan Hoti– Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, anëtar
   **1.6.** Lulzim Krasniqi– Drejtoria për Arsim, anëtar
   **1.7.** Shemsije Deliu– Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, anëtare
   **1.8.** Jeton Kryeziu– Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, anëtar
   **1.9.** Mirsad Shala– Zyra Ligjore, anëtar
   **1.10.** Fjolla Duraku– Zyra për marrëdhënie me publikun, anëtare
   **1.11.** Alban Gashi– Zyra për barazi gjinore, anëtar

2. Komisioni ka për detyrë që ta bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave dhe të propozimeve për Planin Zhvillimor Komunal (PZHK) 2023– 2031, në Komunën e Rahovecit, të cilat kanë ardhur si rezultat i konsultimit publik të mbajtur me qytetarë të Komunës së Rahovecit dhe të komuniteteve të tjera pjesëmarrëse gjatë konsultimit publik.
3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin aktual në fuqi.
4. Komisioni do ta fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
5. Komisioni do të hartojë raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe për Drejtorinë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***
- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***DUPMM-së, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**
**Kryetari i Komunës**

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Nr. i faq/Br.str/No.pg 102 105
1 / 2 / 23

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, neni 70 paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, i datës 20.10.2022, neni 74 dhe neni 92, paragrafi 1 dhe 4, i Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

**VENDIM**
**Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës**

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: "Lot 2– Rregullimi i terreneve sportive", me numër të kontratës 623-21-4944-5-2-1/C315, si në vijim:

    1.1. Z. Venhar Topalli, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Zyrtar për Shërbime Publike, në Drejtorinë për Shërbime Publike, **CAKTOHET** menaxher i kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

    **1.2.** Z. Afrim Dina, Drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

2. Menaxheri i kontratës me mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të datës 20.10.2022, si dhe Manualet për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me Nr. Prot. 02/1678/22, i datës 9.3.2022.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Menaxheri i Projektit,***
- ***Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejtë,***
- ***Sektori i Prokurimit,***
- ***Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**
**Zyrtar Kryesor Administrativ**

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Njësia Nr/Br/No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr/Br/No 103 Nr. i faq/Br.str/No.pg 105
Data/Datum/Date 1 / 2 / 23

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70 paragrafi 70.18 i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

**V E N D I M**

**Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës**

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: "Ndërtimi i parqeve në Komunën e Rahovecit" me numër të kontratës 623-21-4279-5-2-1/C302, si në vijim:

   **1.1** z. Sokol Thaqi, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Koordinator i projektit "Ekipi Rajonal për Projekte Komunale (ERPK)", sipas kontratës së AZHR-së, **CAKTOHET** menaxher i kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

   **1.2** z. Albnor Mullabazi, Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, si dhe Manualet për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me Nr. Prot. 02/980/21 i datës 15.9.2021.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Menaxheri i Projektit,***
- ***Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejtë,***
- ***Sektori i Prokurimit,***
- ***Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**
**Zyrtar Kryesor Administrativ**

Nr/Br/No 104 Nr. i faq/Br.str/No.pg 105
Data/Datum/Date 1/12/23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70 paragrafi 70.18 i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

**VENDIM**
**Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës**

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: "Ndërtimi i shtratit të përroit në lagjen Kelmendi në Kramovik" me numër të kontratës 623-21-4766-5-2-1/C303, si në vijim:

   **1.1** z. Sokol Thaqi, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Koordinator i projektit "Ekipi Rajonal për Projekte Komunale (ERPK)", sipas kontratës së AZHR-së, **CAKTOHET** menaxher i kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

   **1.2** z. Albnor Mullabazi, Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, si dhe Manualet për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me Nr. Prot. 02/966/21 i datës 10.9.2021.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Menaxheri i Projektit,***
- ***Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejtë,***
- ***Sektori i Prokurimit,***
- ***Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**
**Zyrtar Kryesor Administrativ**

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 107 Nr. i faq/Br.str/No.pg 105
Data/Datum/Date 1/2/23

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, Thirrjes publike për aplikim për OJQ-të, nga Drejtoria për Shërbime Publike me Nr. Prot. 119, të datës 17.1.2023, nenit 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4, i Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**VENDIM**
**Për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve**

1. **Caktohet** komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për OJQ-të, për hartimin e planit të veprimit komunal për energji dhe klimë (PVKEK) sipas thirrjes publike për aplikim me Nr. Prot. 119 të datës 17.1.2023, në këtë përbërje:
   1.1. Diellza Çanta, kryesuese;
   1.2. Bjondina Ramaj, anëtare;
   1.3. Venhar Topalli, anëtar;
   1.4. Flutura Beqiri, anëtare;
   1.5. Nazmi Bellaqa, anëtar nga Shoqëria Civile.

2. Komisioni ka për detyrë që ta bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për OJQ-të, për hartimin e planit të veprimit komunal për energji dhe klimë (PVKEK), sipas thirrjes publike për aplikim me Nr. Prot. 119 të datës 17.1.2023.

3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin aktual në fuqi.

4. Obligohet komisioni që pas përfundimit të punëve të hartojë raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Shërbime Publike.

5. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.

6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Drejtoria për Shërbime Publike.

7. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Drejtorisë për Shërbime Publike, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY OF RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 109 Nr. i faq/Br.str/No.pg 105
Data/Datum/Date 2 / 2 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005, të datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

**VENDIM**
**Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave**

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: "Shërbime për të gjitha manifestimet e aktivitetet kulturore për vitin 2023, shërbime me LED profesional, zërimit dhe ndriçimit profesional për nevojat e Komunës së Rahovecit", me Nr. prokurimi: 623-23-225-2-3-6 dhe Nr. të brendshëm 623-23-005-2-3-6 të datës: 1.2.2023, në këtë përbërje:

   **1.1.** Muharem Morina, kryesues
   **1.2.** Faik Thaqi, anëtar
   **1.3.** Vjollca Berisha, anëtare

2. Komisioni ka për detyrë ta bëjë vlerësimin e ofertave për projektin "Shërbime për të gjitha manifestimet e aktivitetet kulturore për vitin 2023, shërbime me LED profesional, zërimit dhe ndriçimit profesional për nevojat e Komunës së Rahovecit", me Nr. prokurimi: 623-23-225-2-3-6 dhe Nr. të brendshëm 623-23-005-2-3-6, të datës: 1.2.2023.

3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

4. Komisioni do ta fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.

5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***
- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E RAHOVECIT - KRYETARI I KOMUNËS - REPUBLIC OF KOSOVA / MUNICIPALITY RAHOVEC MAYOR - ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr. 112 Nr. i faq/Br.str/No.pg 106
Data 3 2 23

Në mbështetje të nenit 13, nenit 58, pika (f) lidhur me nenin 62, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 8, paragrafi 5, pika 5.2., të Udhëzimit Administrativ (MAPL), Nr. 01/2018, për caktimin e stafit mbështetës në komuna, e në mbështetje të nenit 81, paragrafi 1.1. dhe nenit 84, paragrafi 2, të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

**VENDIM**
**Për lirim nga pozita e zyrtarit administrativ në Kabinetin e Kryetarit të Komunës së Rahovecit dhe këshilltar për kategoritë e dala nga lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës**

1. Z. Sabahajdin Cena, nga Rahoveci, **lirohet** nga pozita e zyrtarit administrativ në Kabinetin e Kryetarit të Komunës së Rahovecit dhe këshilltar për kategoritë e dala nga lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

2. Obligohet Njësia e Personelit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa, që të lartpërmendurin ta largojë nga lista e pagës.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Njësia e Personelit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Drejtoria për Buxhet dhe Financa,***
- ***Njësia e Personelit, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi,**
**Kryetari i Komunës**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR'S CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 114 Nr. i faq/Br.str/No.pg 106
Data/Datum/Date 6 / 2 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, të nenit 15, të Ligjit Nr. 08/L-114, për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave *(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 22/2022)*, të nenit 3, paragrafi 6, i Rregullores për funksionimin e Komisionit Komunal të Regjistrimit Nr. 01-01-2023, të datës 6.1.2023 dhe të neneve 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

# V E N D I M
## Për formimin e Komisionit Komunal të Regjistrimit (KKR)

1. Me këtë vendim, **Formohet** Komisioni Komunal i Regjistrimit (KKR), në Komunën e Rahovecit, për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, në këtë përbërje:

   **1.1.** Smajl Latifi– Kryetari i Komunës, kryesues;
   **1.2.** Erseka Cana– Shoqëria Civile, anëtare;
   **1.3.** Lendrit Qeli– Zyra Komunale për Kthim dhe Komunitete, anëtar;
   **1.4.** Berat Duraku- Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, anëtar;
   **1.5.** Besnik Hoti- Drejtor i Drejtorisë për Administratë, anëtar;
   **1.6.** Albnor Mullabazi- Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, anëtar;
   **1.7.** Përparim Krasniqi- Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike, anëtar;
   **1.8.** Nora Boshnjaku- Drejtore e Drejtorisë për Inspektim, anëtare;
   **1.9.** Përfaqësues nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, anëtar/e.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit Komunal të Regjistrimit (KKR) janë: siguron hapësirat për trajnime dhe aktivitete të tjera (tre (3) muaj para datës së fillimit të Regjistrimit); siguron së paku një zyrë për një periudhë dy (2)- mujore para dhe gjatë Regjistrimit; si dhe një periudhë dy (2)- javore pas Regjistrimit; ofron ndihmë teknike gjatë trajnimeve, merr pjesë në trajnime, organizon dhe realizon projektin e Regjistrimit në komunën përkatëse, duke i marrë në konsideratë kërkesat e përcaktuara sipas ligjit për përdorimin e gjuhëve; zbaton rekomandimet e Agjencisë së Statistikave të Kosovës; merr pjesë në përzgjedhjen e regjistruesve në komunë, sipas njoftimeve në bashkëpunim me Agjencinë e Statistikave të Kosovës; ndërhyn në çdo situatë që shfaqet si pengesë gjatë procesit të Regjistrimit; mbikëqyr regjistruesit, siguron funksionimin normal gjatë fazës së Regjistrimit; koordinon aktivitet me mbikëqyrësit dhe stafin e Agjencisë së Statistikave të Kosovës; pranon, shpërndanë dhe grumbullon materialet/dokumentet sipas njoftimeve të Agjencisë së Statistikave të Kosovës; raporton çdo javë lidhur me zhvillimin e procesit të Regjistrimit, brenda territorit të komunës.

3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-114, për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave dhe Rregulloren për funksionimin e Komisionit Komunal të Regjistrimit Nr. 01-01-2023, të datës 6.1.2023.

4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen të gjithë anëtarët e Komisionit Komunal të Regjistrimit (KKR).

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Agjencisë së Statistikave të Kosovës,***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 117 Nr. i faq/Br.str/No.pg 106
Data/Datum/Date 6 / 2 / 23

Në mbështetje të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), dispozitave të nenit 23 lidhur me nenin 56 paragrafi 2 pika 2.3 dhe 2.5 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**VENDIM**
**Për kompensimin e punës shtesë jashtë orarit të rregullt të punës për muajin Janar 2023**

1. Me këtë vendim **lejohet** kompensimi i punës shtesë jashtë orarit të rregullt të punës për muajin Janar 2023 për zyrtarët e Komunës së Rahovecit, si në vijim:
   **1.1.** Ruzhdi Krasniqi - 32 orë për pagesë;
   **1.2.** Luan Sharku – 32 orë për pagesë;
   **1.3.** Kushtrim Zeka – 32 orë për pagesë;

2. Mjetet për pagesën e punëve jashtë orarit të rregullt sigurohen nga kodi Paga dhe Mëditje.

3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

*Arsyetim*

Duke marrë parasysh se zyrtarët e lartpërmendur, për shkak të volumit të madh të punëve dhe punës të cilën duhet të kryejnë edhe jashtë orarit të rregullt të punës janë të obliguar që të punojnë edhe jashtë orarit të rregullt të punës.

Andaj, duke marrë parasysh këtë, zyrtarët e lartëpërmendur kanë të drejtë kompensimi për punën shtesë për orët të cilët kanë punuar jashtë orarit të rregullt të punës sipas legjislacionit të fuqi në Republikën e Kosovës.

Andaj, nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Drejtoria për Buxhet dhe Financa,***
- ***Zyra e personelit, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**
**Kryetari i Komunës**

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia/Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 118 Nr. i faq/Br.str/No.pg 106
Data/Datum/Date 6 / 2 / 23

Në mbështetje të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 21 paragrafi 3 pika 3.1 i të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civil Nr. 03/L-147 i datës 13.05.2010 dhe nenit 11 paragrafi 6 pika 6.1 i Rregullores Nr. 33/2012 për shtesat në paga dhe kompensime të tjera të nëpunësve civil, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

**VENDIM**
**Për kompensimin e punës shtesë jashtë orarit të rregullt të punës për muajin Janar 2023**

1. Me këtë vendim **lejohet** kompensimi i punës shtesë jashtë orarit të rregullt të punës për muajin Janar 2023 për zyrtarët e Komunës së Rahovecit, si në vijim:
   **1.1.** Muharem Morina - 32 orë për pagesë;
   **1.2.** Skender Hamza – 32 orë për pagesë;
   **1.3.** Mirsad Shala – 32 orë për pagesë;
   **1.4.** Senad Mullaavda – 32 orë për pagesë;
   **1.5.** Bjondina Ramaj – 32 orë për pagesë;
   **1.6.** Astrit Mullabazi – 32 orë për pagesë.

2. Mjetet për pagesën e punëve jashtë orarit të rregullt sigurohen nga kodi Paga dhe Mëditje.

3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Arsyetim***

Duke marrë parasysh se zyrtarët e lartpërmendur, për shkak të volumit të madh të punëve dhe punës të cilën duhet të kryejnë edhe jashtë orarit të rregullt të punës janë të obliguar që të punojnë edhe jashtë orarit të rregullt të punës.

Andaj, duke marrë parasysh këtë, zyrtarët e lartëpërmendur kanë të drejtë kompensimi për punën shtesë për orët të cilët kanë punuar jashtë orarit të rregullt të punës sipas legjislacionit të fuqi në Republikën e Kosovës.

Andaj, nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Drejtoria për Buxhet dhe Financa,***
- ***Zyra e personelit, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**
**Kryetari i Komunës**

**Republika e Kosovës**

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

***Komuna e Rahovecit***

*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*

**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 03/Kabineti i Kryetarit të Komunës
Nr./Br./No 119 Nr. i faq/Br.str/No.pg 106
Data/Datum/Date 6 / 2 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017 dhe nenit 4, paragrafi 4, dhe nenit 22, paragrafi, 1 pika 1.3, i Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427, të datës 28.4.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

## VENDIM

1. **MIRATOHET** kërkesa e z. [illegible] nga Rahoveci, me Nr. Protokoli 259, të datës 26.1.2023, për ndihmë financiare prej [illegible] (katërqind e pesëdhjetë euro), për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe të akomodimit për pjesëmarrje në maratonën e vrapimit të gjatë.

2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Zyrës së Kryetarit.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Arsyetim***

[illegible] nga Rahoveci, është njëri nga sportistët e pavarur, njëri nga sportistët e dalluar dhe të rrallë të Komunës së Rahovecit, në vrapim, në maratona të vrapimit të gjatë, ka marrë pjesë në maratona të shumta në nivel vendi, si dhe jashtë Republikës së Kosovës.

Duke marrë parasysh se, i lartpërmenduri, pas regjistrimit, është ftuar që të marrë pjesë në 3 (tri) maratona të radhës në Romë, Vjenë dhe Oslo, në vrapim të gjatë, për shkak të shpenzimeve të shumta, është e domosdoshme ndihma financiare për pjesëmarrje në këto gara.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***[illegible] nga Rahoveci,***
- ***Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport,***
- ***Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Njësia ... (Komunës)
Nr./Br 127 ... 107
Data/D... 7 2 23
RAI

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28-2008), Udhëzimit Administrativ Nr. MSHP 2004/07 për Udhëtimet Zyrtare, nenit 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005, të datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

## VENDIM
**Për lejimin e udhëtimit zyrtar**

1. Me këtë vendim i **lejohet** udhëtimi zyrtar z. Artan Asllani, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Zyrtar për regjistrimin e bizneseve në Drejtorinë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm në Komunën e Rahovecit.

2. Z. Artan Asllani do të marrë pjesë në trajnimin me temën "Menaxhimi i skemave të granteve", i cili organizohet nga Preda Plus Kosovë, në partneritet me Wentrepreneuer, i cili do të mbahet nga data 8.2.2023, deri me datë 11.2.2023, në Ohër të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

3. I lartpërmenduri ka të drejtë të udhëtojë zyrtarisht dhe të zgjedhë mënyrën e udhëtimit varësisht nga organizimi.

4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset i lartpërmenduri dhe Sektori për Komunitete dhe Kthim në Komunën e Rahovecit.

5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Z. Artan Asllani,***
- ***Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 128 Nr. i faq/Br.str/No.pg 107
Data/Datum/Date 7 / 2 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28-2008), Udhëzimit Administrativ Nr. MSHP 2004/07 për Udhëtimet Zyrtare, nenit 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

## VENDIM
## Për lejimin e udhëtimit zyrtar

1. Me këtë vendim i **lejohet** udhëtimi zyrtar z. Lendrit Qeli, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Udhëheqës i sektorit për Komunitet dhe Kthim, në Zyrën e Kryetarit të Komunës.

2. Z. Lendrit Qeli do të marrë pjesë në trajnimin me temën "Menaxhimi i skemave të granteve", i cili organizohet nga Preda Plus Kosovë, në partneritet me Wentrepreneuer, i cili do të mbahet nga data 8.2.2023, deri me datë 11.2.2023, në Ohër të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

3. I lartpërmenduri ka të drejtë të udhëtojë zyrtarisht dhe të zgjedhë mënyrën e udhëtimit varësisht nga organizimi.

4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset i lartpërmenduri dhe Sektori për Komunitete dhe Kthim në Komunën e Rahovecit.

5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Z. Lendrit Qeli,***
- ***Sektori për Komunitet dhe Kthim, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

për: [signature]

**Kryetari i Komunës**

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kr...)
Nr./Br./No 129 Nr. i faq/Br. st... 107
Data/Datum/Date 7. 2. 23
RAHOVEC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

**VENDIM**
**Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës**

1. **Caktohet** menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: "Meremetimi i rrugëve dhe i trotuareve me kubëza– Lot 2", me numër të kontratës 623-21-1972-5-1-1, si në vijim:

    1.1. Znj. Diellza Çanta, e sistemuar në punë dhe detyrat e punës Zyrtare për efiçiencë të energjisë, në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, **CAKTOHET** menaxhere e kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

    1.2. Z. Përparim Krasniqi, Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen ta bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të datës 20.10.2022, si dhe Manualet për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***
- ***Menaxheri i Projektit,***
- ***Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejtë,***
- ***Sektori i Prokurimit,***
- ***Drejtoria për Shërbime Publike, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**
**Kryetari i Komunës**
**Zyrtar Kryesor Administrativ**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Nr/Br/No 132 Nr. i faq 108
Data 8/2/23

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

# VENDIM
## Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: "Renovime në SHFMU "Bekim Sylka" në Rahovec", me Nr. prokurimi: 623-23-535-5-3-5 dhe Nr. të brendshëm 623-23-9042-5-2-1/5 të datës: 07.02.2023, në këtë përbërje:

    **1.1.** Jeton Krasniqi, kryesues
    **1.2.** Faik Thaqi, anëtar
    **1.3.** Arta Kabashi, anëtare

2. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për projektin "Renovime në SHFMU "Bekim Sylka" në Rahovec", me Nr. prokurimi: 623-23-535-5-3-5 dhe Nr. të brendshëm 623-23-9042-5-2-1/5 të datës: 07.02.2023.

3. Obligohet komisioni që këto punë ti kryej duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.

5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR'S CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 137 Nr. i faq/Br.str/No.pg 108
Data/Datum/Date 9 / 2 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës, Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005, të datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

# VENDIM
## Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: "Furnizim me material administrativ për nevojat e QKMF-së", me Nr. prokurimi: 623-23-490-1-3-6 dhe Nr. të brendshëm 623-23-010-1-3-6, të datës: 8.2.2023, në këtë përbërje:

   **1.1.** Saranda Rama, kryesuese;
   **1.2.** Etnik Popaj, anëtar;
   **1.3.** Dafina Gashi, anëtare.

2. Komisioni ka për detyrë ta bëjë vlerësimin e ofertave për projektin "Furnizim me material administrativ për nevojat e QKMF-së", me Nr. prokurimi: 623-23-490-1-3-6 dhe Nr. të brendshëm 623-23-010-1-3-6, të datës: 8.2.2023.

3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

4. Komisioni do ta fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.

5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E RAHOVECIT
KRYETARI I KOMUNËS
RAHOVEC
ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 136 Nr. i faq/Br.str/No.pg 108
Data/Datum/Date 9 / 2 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92, të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005, të datës: 29.3.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

**VENDIM**
**Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave**

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: "Furnizim me pako pedagogjike", me Nr. prokurimi: 623-23-560-1-3-6 dhe Nr. të brendshëm 623-23-013-1-3-6, të datës: 8.2.2023, në këtë përbërje:

   1.1. Admirim Durguti, kryesues;
   1.2. Liridon Gashi, anëtar;
   1.3. Vjollca Berisha, anëtare.

2. Komisioni ka për detyrë ta bëjë vlerësimin e ofertave për projektin "Furnizim me pako pedagogjike", me Nr. prokurimi: 623-23-560-1-3-6 dhe Nr. të brendshëm 623-23-013-1-3-6 të datës: 8.2.2023.

3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

4. Komisioni do ta fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.

5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / KOMUNA E RAHOVECIT / KRYETARI I KOMUNËS / RAHOVEC ORAHOVAC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 145 Nr. i faq/Broj str/No.pg 109
Data/Datum/Date 9/2/23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës, Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92, të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005, të datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

**VENDIM**
**Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave**

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: "Blerja e dy autoambulancave", me Nr. prokurimi: 623-23-162-1-2-1 dhe Nr. të brendshëm 623-23-002-1-2-1, të datës: 9.2.2023, në këtë përbërje:

   **1.1.** Samir Hasku, kryesues;
   **1.2.** Agim Ejupi, anëtar;
   **1.3.** Etnik Popaj, anëtar.

2. Komisioni ka për detyrë ta bëjë vlerësimin e ofertave për projektin "Blerja e dy autoambulancave", me Nr. prokurimi: 623-23-162-1-2-1 dhe Nr. të brendshëm 623-23-002-1-2-1, të datës: 9.2.2023.

3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

4. Komisioni do ta fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.

5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

*Komuna e Rahovecit*

*Opština Orahovac/ Municipality Rahovec*

**Kryetari i Komunës – Prešednik Opstine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 144 Nr. i faq/Br.str/No.pg 109
Data/Datum/Date 9/2/23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 24 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

## VENDIM
## Për caktimin e komisionit për vlerësimin e pronës komunale për këmbim

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e pronës komunale, për këmbim me pronën private, në përbërje prej:
    1.1. Alban Gashi, kryesues;
    1.2. Miftar Krasniqi, anëtar;
    1.3. Ekrem Bytyqi, anëtar.

2. Komisioni ka për detyrë ta bëjë vlerësimin e Pronës Komunale me Nr. P-71510033-01038-2 në Zonën Kadastrale Xërxë, në posedim të Komunës së Rahovecit, e cila është rezultat i këmbimit me pronën private me Nr. P-71510033-01041-1, në Zonën Kadastrale Xërxë, pasi nuk ekzistojnë prona të tjera të komunës, të përshtatshme për qëllimin e këmbimit.

3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

4. Obligohet komisioni që pas përfundimit të punës të hartojë raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

5. Komisioni do ta fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.

6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit.

7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

1. ***Anëtarëve të komisionit,***
2. ***Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,***
3. ***Arkivit.***

Smajl Latifi,

Kryetari i Komunës

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT
KRYETARI I KOMUNËS
RAHOVEC
ORAHOVAC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 146 Nr. i fq/Br.str/No.pg 109
Data/Datum/Date 9/2/23

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92, të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005, të datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

**V E N D I M**
**Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave**

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: "Furnizim me gypa PVC", me Nr. prokurimi: 623-23-171-1-2-1 dhe Nr. të brendshëm 623-23-004-1-2-1, të datës: 9.2.2023, në këtë përbërje:

   1.1. Diellza Çanta, kryesuese;
   **1.2.** Egzon Thaqi, anëtar;
   **1.3.** Enise Dina, anëtare.

2. Komisioni ka për detyrë ta bëjë vlerësimin e ofertave për projektin "Furnizim me gypa PVC", me Nr. prokurimi: 623-23-171-1-2-1 dhe Nr. të brendshëm 623-23-004-1-2-1, të datës: 9.2.2023.

3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

4. Komisioni do ta fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.

5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***
- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**
**Kryetari i Komunës**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 148 Nr. i faq/Br.str/No.pg 109
Data/Datum/Date 10 / 2/ 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")* dhe neneve 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**VENDIM**
**Për caktimin e komisionit për verifikimin e gjendjes faktike, vlerësimin e aseteve dhe të objektit**

1. **Caktohet** komisioni për verifikimin e gjendjes faktike dhe vlerësimin e aseteve në Parcelën sipas Certifikatës me Nr. P-71510008-00266-0, në zonën kadastrale Hoçë e Madhe, në posedim të P.SH.E KOSOV.K.K.RAHOVEC, në këtë përbërje:

   **1.1.** Fidan Hoti, kryesues;
   **1.2.** Valon Hoti, anëtar;
   **1.3.** Sylejman Daka, anëtar;
   **1.4.** Egzon Thaqi, anëtar;
   **1.5.** Ilir Haxhijaha, anëtar.

2. Komisioni ka për detyrë që ta bëjë verifikimin e gjendjes faktike, vlerësimin e aseteve dhe të objektit në Parcelën sipas Certifikatës me Nr. P-71510008-00266-0, në zonën kadastrale Hoçë e Madhe, në posedim të P.SH.E KOSOV.K.K.RAHOVEC.

3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në Certifikatën me Nr. P-71510008-00266-0, vendimin e Kuvendit Komunal Rahovec 01 Nr. 149/2006, të datës 14.7.2006 dhe në legjislacionin aktual në fuqi.

4. Obligohet komisioni që të hartojë raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, si dhe raporti të dorëzohet më së largu me datë 16 shkurt 2023.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**
**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT
KRYETARI I KOMUNËS
RAHOVEC
ORAHOVAC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 147 Nr. i faq/Br.str/No.pg 02
Data/Datum/Date 10 / 2 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005, i datës 29.3.2017 dhe nenit 7, paragrafi 1, i Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve të Komunës së Rahovecit, Nr. 1427, të datës 28.4.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

## VENDIM
### Për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve për ndihma momentale për vitin 2023

1. **Caktohet** komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve për ndihmat momentale për vitin 2023, në këtë përbërje:
   - 1.1. Dr. Ardian Morina, kryesues;
   - 1.2. Saranda Rama, anëtare;
   - 1.3. Goneta Mustafa, anëtare;
   - 1.4. Ekrem Bytyqi, anëtar;
   - 1.5. Nazmi Bellaqa, anëtar nga shoqëria civile.

2. Komisioni ka për detyrë që ta bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve për ndihma momentale, për banorët rezidentë, për përballimin e shpenzimeve sipas kritereve të parapara në nenin 21, të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve të Komunës së Rahovecit, Nr. 1427, të datës 28.4.2017.

3. Obligohet komisioni që të veprojë duke u bazuar në legjislacionin për financat publike dhe Rregulloren Nr. 1427, të datës 28.4.2017 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat për Ndarjen e Subvencioneve.

4. Anëtarët e komisionit për vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve, mbajnë përgjegjësi për zbatimin e drejtë të kritereve për ndarjen e subvencioneve.

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***
- ***Anëtarët e komisionit,***
- ***DSHPS, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**
**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE / MAYOR
RAHOVEC ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 149 Nr. i faq/Br.str/No.pg 109
Data/Datum/Date 10/2/23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.1 dhe 2.2 i Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

## VENDIM

1. **MIRATOHET** kërkesa e z. [illegible] Ratkoc, Komuna e Rahovecit me Nr. Protokolit 399, të dt. 7.2.2023 për ndihmë financiare prej [illegible]€ (njëmijë euro) për mbulimin e shpenzimeve te mjekimit dhe blerjen e barnave për tretman të sëmundjes.

2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe përkujdesje Sociale dhe do të transferohen në xhirollogari të [illegible] Nr. 1501130000112494 në Raiffeisen Bank.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

### *Arsyetim*

z. [illegible] vuan nga sëmundja e rëndë, e cila ka nevojë për tretman të vazhdueshëm për shërimin e saj. Shërimi i sëmundjes për të është tejet i kushtueshëm dhe ka kosto të lartë financiare të papërballueshme për të, pasi që asnjë anëtar i familjes nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme.
Andaj, duke marrë parasysh gjendjen e rëndë shëndetësore dhe financiare të të lartpërmendurit, pasi që shpenzimet e mjekimit dhe të blerjes së barnave për shërimin kanë kosto të lartë financiare, ai e ka të vështirë mbulimin e shpenzimeve elementare për jetesë dhe blerjen e barnave për shërimin e sëmundjes, kështu që është e domosdoshme ndihma për tejkalimin e kësaj gjendjeje.
Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

***Me vendim të njoftohen:***

- ***[illegible],***
- ***Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,***
- ***Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**
**Kryetari i Komunës**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 157 Nr. i faq/Br.str/No.pg 110
Data/Datum/Date 13 / 2 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës, Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92, të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005, të datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

## VENDIM
### Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: "Konsulencë për hartimin e projekteve për fermerë dhe biznese", me Nr. prokurimi: 623-23-434-2-2-1 dhe Nr. të brendshëm 623-23-012-2-2-1, të datës: 10.2.2023, në këtë përbërje:

   **1.1.** Egzon Thaqi, kryesues;
   **1.2.** Kosovare Gashi, anëtare;
   **1.3.** Enise Dina, anëtare;

2. Komisioni ka për detyrë ta bëjë vlerësimin e ofertave për projektin "Konsulencë për hartimin e projekteve për fermerë dhe biznese", me Nr. prokurimi: 623-23-434-2-2-1 dhe Nr. të brendshëm 623-23-012-2-2-1, të datës: 10.2.2023.

3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

4. Komisioni do ta fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.

5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna Rahovec*
*OpštinaOrahovac / Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Mayor Office**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 158 Nr. i faq/Br.str/No pg 110
Data/Datum/Date 13/2/23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008"), nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005, i datës 29.3.2017 dhe Rregullores për dhënien e titujve të nderit, të dekoratave dhe të çmimeve nga Komuna e Rahovecit 01 Nr. 327/22, të datës 31.5.2022, Kryetari i Komunës, merr këtë:

## VENDIM
### Për caktimin e komisionit për ndarjen e Titullit të Nderit "Medalja e Lirisë"

1. **Caktohet** komisioni për ndarjen e Titullit të Nderit "Medalja e Lirisë", në Komunën e Rahovecit për nder të 17 Shkurtit - Ditës së shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, në këtë përbërje:
   - **1.1.** Besa Hoxha - Beqiri, kryesuese;
   - **1.2.** Dervish Çadraku, anëtar;
   - **1.3.** Shkumbin Arifi, anëtar;
   - **1.4.** Fehmi Isma, anëtar;
   - **1.5.** Qemajl Krasniqi, anëtar.

2. Komisioni ka për detyrë ta bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e personaliteteve për ndarjen e Titullit të Nderit "Medalja e Lirisë", në Komunën e Rahovecit si dhe t'ia rekomandojë Kryetarit të Komunës personalitetin të cilit duhet t'i jepet Titulli i Nderit "Medalja e Lirisë" për kontributin e tij për çlirimin e atdheut në periudha të ndryshme të historisë kombëtare.

3. Obligohet komisioni që të veprojë duke u bazuar në Rregulloren për dhënien e titujve të nderit, të dekoratave dhe të çmimeve nga Komuna e Rahovecit 01 Nr. 327/22, të datës 31.5.2022, si dhe ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi në Republikën e Kosovës.

4. Komisioni do ta fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë deri më datë 16 shkurt 2023.

5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen anëtarët e Komisionit dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

6. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E RAHOVECIT
KRYETARI I KOMUNËS
RAHOVEC
ORAHOVAC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 159 Nr. i faq/Br.str/No pg 110
Data/Datum/Date 13/2/23
RAHOVEC/ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, ( Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008 ), nenit 4, paragrafi 4 dhe nenit 22 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.4.2017, neneve 74 dhe 92, të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

# V E N D I M

1. **APROVOHET** kërkesa me Nr.481, e datës 13.2.2023, e Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dega Rahovec dhe i lejohet furnizimi me derivate të naftës, në sasi prej **70 L** ( shtatëdhjetë litra), për nevojat lidhur me aktivitetet e shoqatave të dala nga lufta për manifestimet dhe për përvjetorët e Dëshmorëve (Homazhet), për muajin Shkurt .

2. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa .

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

***U dërgohet :***

- ***OVL-UÇK-së, dega në Rahovec,***
- ***Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 160 Nr. i faq[illegible] 110
[illegible]Date 13 / [illegible]
RAHOVEC / ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***KomunaRahovec***
*OpštinaOrahovac/Municipality Rahovec*

**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Mayor Office**

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës Nr. 03/L040,(Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës Nr. 1005, i datës 29.3.2017, nenit 22 të Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, me Nr. prot. 1427, të datës: 28.4.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë :

## VENDIM
**Për ekzekutimin e mjeteve financiare**

1. Me këtë vendim, **lejohet** ekzekutimi i mjeteve financiare në shumë prej [illegible] € (treqind euro) për [illegible] nga Tirana, Republika e Shqipërisë, i cili është shpallur fitues i çmimit të dytë për krijimtarinë letrare për të rritur, sipas Konkursit të shpallur me nr. prot.147, të datës: 7.11.2022.

2. Mjetet do të sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***U dërgohet :***

- [illegible],
- ***Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport,***
- ***Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**
**Kryetar i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE
RAHOVEC / ORAHOVAC

KOMUNA RAHOVEC/OPSTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 161 Nr. i faq/Br. str./Page 1/1
Data/Datum/Date 13/
RAHOVEC / ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***KomunaRahovec***
*OpštinaOrahovac/Municipality Rahovec*

**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Mayor Office**

---

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës Nr. 03/L040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës Nr. 1005, i datës 29.3.2017, nenit 22, të Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve me Nr. prot. 1427, të datës 28.4.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë :

## V E N D I M
### Për ekzekutimin e mjeteve financiare

1. Me këtë vendim, **lejohet** ekzekutimi i mjeteve financiare në shumë prej [redacted] (dyqind euro) për [redacted] nga Lezha, Republika e Shqipërisë, e cila është shpallur fituese e çmimit të tretë për krijimtarinë letrare për të rritur, sipas Konkursit të shpallur me nr. prot.147, të datës: 7.11.2022.

2. Mjetet do të sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***U dërgohet :***

- [redacted]
- ***Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport,***
- ***Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT
KRYETARI I KOMUNËS
RAHOVEC ORAHOVAC

KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 162 Nr. i f... pg. 111
Data/Datum/Date 13 / ...
RAHOVEC / ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

*KomunaRahovec*
*OpštinaOrahovac/Municipality Rahovec*

**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Mayor Office**

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës Nr. 03/L040,(Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës Nr. 1005, i datës 29.3.2017, nenit 22, të Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve me Nr. prot. 1427 të datës: 28.4.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë :

**V E N D I M**
**Për ekzekutimin e mjeteve financiare**

1. Me këtë vendim, **lejohet** ekzekutimi i mjeteve financiare në shumë prej 70 € (shtatëdhjet euro) për **znj. [illegible]** nga fshati Drenoc, Komuna e Rahovecit, shifra 0023, e cila është shpallur fituese e çmimit të tretë për krijimtarinë letrare sipas Konkursit të shpallur nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport 13 Nr. zyrtar – 2023, të datës: 10.1.2023.

2. Mjetet do të sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***U dërgohet :***

- ***Znj. [illegible]***
- ***Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport ,***
- ***Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**
**Kryetar i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / KOMUNA E RAHOVECIT / KRYETARI I KOMUNËS / RAHOVEC ORAHOVAC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 163 Nr. i faq/Br. str/No.pg 111
Data/Datum/Date 13 /
RAHOVEC / ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

*KomunaRahovec*
*OpštinaOrahovac/Municipality Rahovec*

**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Mayor Office**

---

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës Nr. 03/L040,(Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës Nr. 1005, i datës 29.3.2017, nenin 22, të Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve me Nr. prot. 1427 të dt. 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë :

**V E N D I M**
**Për ekzekutimin e mjeteve financiare**

1. Me këtë vendim, **lejohet** ekzekutimi i mjeteve financiare në shumë prej [illegible] € (njëqind euro) për znj. [illegible] nga Krusha e Madhe, Komuna e Rahovecit, shifra--6299, e cila është shpallur fituese e çmimit të dytë për krijimtarinë letrare sipas Konkursit të shpallur nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, 13 Nr. zyrtar – 2023, të datës: 10.1.2023.

2. Mjetet do të sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***U dërgohet :***

- [illegible]
- ***Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport,***
- ***Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**
**Kryetar i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT
RAHOVEC ORAHOVAC

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 164 Nr. i faqeve 1 111
Data/Datum/Date 13 /
RAHOVEC / ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***KomunaRahovec***
*OpštinaOrahovac/Municipality Rahovec*

**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Mayor Office**

---

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës Nr. 03/L040,(Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, nenit 22 të Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve me Nr. prot. 1427, të datës: 28.4.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë :

**V E N D I M**
**Për ekzekutimin e mjeteve financiare**

1. Me këtë vendim, **lejohet** ekzekutimi i mjeteve financiare në shumë prej 150 € (njëqind e pesëdhjetë euro) për **znj. [illegible]** nga Krusha e Madhe, Komuna e Rahovecit, shifra Amazonë, e cili është shpallur fituese e çmimit të parë për krijimtarinë letrare, sipas Konkursit të shpallur nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, 13 Nr. zyrtar – 2023, të datës 10.1.2023.

2. Mjetet do të sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***U dërgohet :***

- ***Znj. [illegible],***
- ***Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport,***
- ***Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**
**Kryetar i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE
RAHOVEC ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 165 Nr. i ... /No.pg 111
Data/Datum/Date 13 ... 3
RAHOVEC / ORAHO...

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

---

Në mbështetje të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), dispozitave të nenit 23 lidhur me nenin 56, paragrafi 2, pika 2.3 dhe 2.5, të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nenit 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**VENDIM**
**Për lejimin e pagesës shtesë për punë jashtë orarit**

1. Me këtë vendim, **lejohet** pagesa për punë shtesë jashtë orarit të punës për Besarta Gashin, sipas kërkesës së palëve për lidhjen e kurorës, me datë 29.12.2022, në orën 21:30, e sistemuar në punë dhe detyra të punës Zyrtare e Gjendjes Civile në Rahovec, në Drejtorinë për Administratë, në Komunën e Rahovecit.
2. Besarta Gashi ka të drejtë kompensimi për punën shtesë jashtë orarit të punës që bën, sipas pikës **1** të këtij vendimi dhe atë në shumën fikse pre **30 Euro** (tridhjetë euro), për çdo kurorëzim të bërë jashtë orarit të rregullt të punës dhe jashtë objektit të Komunës.
3. Mjetet për pagesën e punës jashtë orarit të rregullt, do të sigurohen nga kodi për Paga dhe Mëditje.
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe prodhon efekt juridik deri në marrjen e një vendimi tjetër.

***A r s y e t i m***

Besarta Gashi, e sistemuar në punë dhe detyrat e punës Zyrtare e Gjendjes Civile në Rahovec, në Drejtorinë për Administratë, në Komunën e Rahovecit, është e angazhuar në kurorëzimet që bëhen jashtë orarit të punës dhe jashtë objektit të Komunës.
Andaj, duke marrë parasysh vëllimin e punëve dhe angazhimin e Besarta Gashit jashtë orarit të rregullt të punës, gjatë kurorëzimeve jashtë objektit të komunës, ajo është e obliguar që ta kryejë shërbimin e lartëcekur jashtë orarit të punës.
Për këtë arsye, është e domosdoshme që të paguhet puna shtesë jashtë orarit të rregullt të punës për të lartpërmendurën, sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës.
Duke marrë parasysh atë që u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Nëpunëses Besarta Gashi,***
- ***Njësisë së Personelit,***
- ***Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**
**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE
RAHOVEC ORAHOVAC

Nr/Br/No 169
Data/Datum/Date 14.2.23

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës, Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

## VENDIM
### Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: "Furnizimi i bibliotekave me libra", me Nr. prokurimi: 623-23-197-1-2-1 dhe Nr. të brendshëm 623-23-001-1-2-1, të datës: 13.2.2023, në këtë përbërje:

   **1.1.** Liridon Gashi, kryesues,
   **1.2.** Arta Kabashi, anëtare,
   **1.3.** Gërmia Gashi, anëtare.

2. Komisioni ka për detyrë ta bëjë vlerësimin e ofertave për projektin "Furnizimi i bibliotekave me libra", me Nr. prokurimi: 623-23-197-1-2-1 dhe Nr. të brendshëm 623-23-001-1-2-1, të datës: 13.2.2023.

3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

4. Komisioni do ta fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.

5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*KomunaRahovec*
*OpštinaOrahovac/Municipality Rahovec*

**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Mayor Office**

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës, Nr.1005, i datës: 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM

**Formohet komisioni për përzgjedhjen e punimeve në artin figurativ nga nxënësit e shkollave të Komunës së Rahovecit, në kuadër të ekspozitës së 17 Shkurtit 2023**

1. Caktohet Komisioni në këtë përbërje:

    1.1. Selami Haxhijaha, kryesues,
    1.2. Mërgime Hoti, anëtare,
    1.3. Shedat Ukaj, anëtar.

2. Komisioni ka për detyrë që ta bëjë vlerësimin dhe përzgjedhjen e punimeve në artin figurativ, nga nxënësit e shkollave të komunës së Rahovecit, në kuadër të ekspozitës së 17 Shkurtit 2023.

3. Obligohet Komisioni që pas përfundimit të punëve të hartojë raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe për Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport.

4. Komisioni do ta fillojë punën menjëherë dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e Komisionit dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga kryetari i Komunës.

***U dërgohet:***
- ***Anëtarëve të Komisionit,***
- ***Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport***
- ***Arkivit.***

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 171 Nr. i faq/Br.str/No.pg 112
Data/Datum/Date 15 / 2 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*KomunaRahovec*
*OpštinaOrahovac/Municipality Rahovec*

**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Mayor Office**

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës Nr. 03/L040,(Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, 28/2008), të Rregullores së Ministrisë së Financave Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, të Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve me Nr. prot. 1427, të datës: 28.4.2017, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës, Nr.1005, i datës: 29.3.2017, Thirrjes Publike me nr. prot 06, te datës:. 9.2.2023, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**V E N D I M**

**Formohet Komisioni për përzgjedhjen e kandidatëve të jashtëm për vlerësimin e projekt – propozimeve të OJQ-ve**

1. Caktohet Komisioni për vlerësimin e projekt – propozimeve të OJQ-ve në këtë përbërje:

    1.1. Arsim Kastrati, kryesues,
    1.2. Dafina Gashi, anëtare,
    1.3. Luan Danuza, anëtar.

2. Komisioni ka për detyrë që ta bëjë vlerësimin e të gjitha aplikacioneve të pranuara të kandidatëve të jashtëm për vlerësimin e projekt – propozimeve të OJQ-ve.

3. Obligohet Komisioni që pas përfundimit të punëve të hartojë raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe për Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport.

4. Komisioni do ta fillojë punën menjëherë dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e Komisionit dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga kryetari i Komunës.

***U dërgohet :***
- ***Anëtarëve të Komisionit,***
- ***Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport***
- ***Arkivit.***

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 172 Nr. i faq/Br.str/No.pg 172
Data/Datum/Date 15/ 2 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 173 Nr. i faq/Br.str/No.pg 112
Data/Datum/Date 15/2/23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017 dhe nenit 4, paragrafi 4 dhe nenit 21, paragrafi 2, pika 2.1. dhe 2.2., i Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427, të datës 28.4.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

# V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e z. [illegible], Komuna e Rahovecit, me Nr. Protokoli 64, të datës: 11.1.2023 për ndihmë financiare prej [illegible] (pesëqind euro) për mbulimin e shpenzimeve te mjekimit dhe blerjen e barnave për tretman të sëmundjes.

2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe përkujdesje Sociale.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

## *A r s y e t i m*

Z. [illegible] nga sëmundja e rëndë, e cila ka nevojë për tretman të vazhdueshëm për shërimin e saj. Shërimi i sëmundjes për të është tejet i kushtueshëm dhe ka kosto të lartë financiare të papërballueshme për të, pasi asnjë anëtar i familjes nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme.
Andaj, duke marrë parasysh gjendjen e rëndë shëndetësore dhe financiare të të lartpërmendurit, pasi shpenzimet e mjekimit dhe të blerjes së barnave për shërimin kanë kosto të lartë financiare, ai e ka të vështirë mbulimin e shpenzimeve elementare për jetesë dhe blerjen e barnave për shërimin e sëmundjes, kështu që është e domosdoshme ndihma për tejkalimin e kësaj gjendjeje.
Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Me vendim të njoftohen:***

- [illegible]
- ***Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,***
- ***Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**
**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E RAHOVECIT - KRYETARI I KOMUNËS - ORAHOVAC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna Rahovec*
*OpštinaOrahovac / Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Mayor Office**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 174 Nr. i faq/Br.str/No.pg 1/2
Data/Datum/Date 15/2/23
RAHOVEC/ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 2 pika 1.1., nenit 4, paragrafi 4 dhe nenit 22, paragrafi 1, pika 1.3. dhe 1.9 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e ndarjes së subvencioneve me Nr.1427, të datës 28.4.2017 dhe neneve 74 dhe 92, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë :

## VENDIM

1. **MIRATOHET** Kërkesa e Organizatës së Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Rahovec, me Nr. Prot. 538, të datës: 14.2.2023.

2. OVL - UÇK-së, i ndahet shuma në vlerën prej **600.00€ (gjashtëqind euro)** për mbulimin e shpenzimeve të aktiviteteve për nder të 17 Shkurtit, Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, ku janë planifikuar të mbahen disa aktivitete kulturore dhe sportive në bashkëpunim me Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Rahovecit.

3. Mjetet do të sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.

4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet :***

- ***OVL – UÇK-së, në Rahovec,***
- ***Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport,***
- ***Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E RAHOVECIT - KRYETARI I KOMUNËS - RAHOVEC ORAHOVAC - REPUBLIC OF KOSOVA - MUNICIPALITY OF RAHOVEC - MUNICIPAL MAYOR

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 90 të Ligjit Nr. 04/L-027 për Mbrojtjen nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 22/2011")*, nenit 8, paragrafi 2 pika 2.2, nenit 9 dhe nenit 12 të Rregullores (QRK) – Nr. 17/2015 për metodologjinë e vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, dhe nenit 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM

## Për caktimin e Komisionit Komunal për Vlerësimin e Dëmeve të shkaktuara në të mirat materiale nga ndikimi i fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera

1. **Caktohet** Komisioni Komunal për Vlerësimin e Dëmeve të shkaktuara në të mirat materiale nga ndikimi i fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera, në territorin e Komunës së Rahovecit, në këtë përbërje:

   **1.1.** Hasan Vuqitërna, kryesues,
   **1.2.** Artan Asllani, anëtar,
   **1.3.** Vlora Nazifi - Gashi, anëtare,
   **1.4.** Venhar Topalli, anëtar,
   **1.5.** Beqir Hamza, sekretar.

2. Komisioni Komunal për Vlerësimin e Dëmeve, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera, Rregulloren (QRK) – Nr. 17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera si dhe legjislacionin përkatës në fuqi.

3. Mandati i Komisionit Komunal për Vlerësimin e Dëmeve është 4 (katër) vjet.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Anëtarët e komisionit,***
- ***Drejtorët e Drejtorive,***
- ***Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave në MPB, dhe***
- ***Arkivi.***

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 138 Nr. i faq/Br.str/No.pg 112
Data/Datum/Date 15 / 2 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA - KOMUNA E RAHOVECIT - KRYETARI I KOMUNËS
RAHOVEC / ORAHOVAC

# Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 184 Nr. i faq/Br.str/No.pg 113
Data/Datum/Date 16 / 2 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

## VENDIM
**Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave**

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: "Mirëmbajtja e objekteve kulturore, monumenteve, fushave sportive dhe rekreative", me Nr. prokurimi: 623-23-261-2-2-1 dhe Nr. të brendshëm 623-23-006-2-2-1, të datës: 15.2.2023, në këtë përbërje:

   **1.1.** Egzon Thaqi, kryesues,
   **1.2.** Arta Kabashi, anëtare,
   **1.3.** Liridon Gashi, anëtar.

2. Komisioni ka për detyrë ta bëjë vlerësimin e ofertave për projektin "Mirëmbajtja e objekteve kulturore, monumenteve, fushave sportive dhe rekreative", me Nr. prokurimi: 623-23-261-2-2-1 dhe Nr. të brendshëm 623-23-006-2-2-1, të datës: 15.2.2023.

3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

4. Komisioni do ta fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.

5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***
- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**
**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / KRYETARI I KOMUNËS
RAHOVEC ORAHOVAC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 189 Nr. i faq/Br.str/No.pg 113
Data/Datum/Date 20 / 2 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

# VENDIM

## Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: "Hartimi i projekteve të ndryshme në Komunën e Rahovecit", me Nr. prokurimi: 623-23-321-2-1-1 dhe Nr. të brendshëm 623-23-009-2-1-1, të datës: 16.2.2023, në këtë përbërje:

    **1.1.** Jetmir Ukaj, kryesues,
    **1.2.** Sokol Thaqi, anëtar,
    **1.3.** Jeton Krasniqi, anëtar.

2. Komisioni ka për detyrë ta bëjë vlerësimin e ofertave për projektin "Hartimi i projekteve të ndryshme në Komunën e Rahovecit", me Nr. prokurimi: 623-23-321-2-1-1 dhe Nr. të brendshëm 623-23-009-2-1-1, të datës: 16.2.2023.

3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

4. Komisioni do ta fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.

5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT
KRYETARI I KOMUNËS
RAHOVEC
ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 190 Nr. Reg/Br.str/No pg 113
Data/Datum/Date 26.2.23
RAHOVEC / O

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës nr.03/L-040, nenit 49 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, Kërkesës së punëtores, të miratuar nga eprori i drejtpërdrejtë, si dhe nenit 92, të Statutit të komunës, Kryetari i komunës merr këtë:

## VENDIM
### Për dhënien e pushimit të lehonisë

1. **Znj. Blerta Gashi** nga Krusha e Madhe, e cila është në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe e sistemuar në punët dhe detyrat e punës: Zyrtare për Informim, në Zyrën e Kryetarit të Komunës, i aprovohet pushimi i lehonisë në kohëzgjatje prej 12 muajsh, sipas dispozitave të përcaktuara me Ligjin e Punës Nr. 03/L-212.
2. E lartprmendura, sipas Ligjit të Punës, 6 (gjashtë) muajt e parë të pushimit të lehonisë do të paguhet nga punëdhënësi me kompensim 70% të pagës bazë, nga data data 11.2.2023, deri më 11.8.2023, kurse 3 (tre) muajt në vijim, pushimi i lehonisë paguhet nga Qeveria e Kosovës me kompensim 50% të pagës mesatare në Kosovë, nga data 12.8.2023, deri më 12.11.2023, ndërsa 3 muajt e tjerë do të jenë pa pagesë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës

### Arsyetim

Punonjësja **Blerta Gashi** nga Krusha e Madhe, e cila është në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe e sistemuar në punët dhe detyrat e punës: Zyrtare për Informim në Zyrën e Kryetarit të Komunës se, nga data 11.2.2023, do të shkojë në pushim të lehonisë, sipas fletëlëshimit me Nr.1904 të spitalit Regjional të Prizrenit "Prim. Dr. Daut Mustafa".
Duke pasur parasysh se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore që punëtorja ta realizojë pushimin e lehonisë, data e shkuarjes në pushim të lehonisë konfirmohet sipas fletëlëshimit të spitalit.
Nga sa u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshilla Juridike:** Nëpunësja ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, nga dita e marrjes së këtij vendimi.

*Vendimi u dërgohet*:

- **Znj. Blerta Gashi,**
- **Zyrës së Kryetarit të komunës,**
- **Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,**
- **Dosjes së punëtores,**
- **Njësisë së personelit.**

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / KOMUNA E RAHOVECIT / KRYETARI I KOMUNËS / RAHOVEC / ORAHOVAC

# Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 192 Nr. i faq/Br.str/No.pg 1½
Data/Datum/Date 20 / 2 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

## VENDIM
**Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave**

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: "Furnizimi i bibliotekave me libra", me Nr. prokurimi: 623-23-197-1-2-1 dhe Nr. të brendshëm 623-23-001-1-2-1, të datës: 13.2.2023, në këtë përbërje:

   **1.1.** Antigona Krasniqi, kryesuese,
   **1.2.** Arta Kabashi, anëtare,
   **1.3.** Gërmia Gashi, anëtare.

2. Komisioni ka për detyrë ta bëjë vlerësimin e ofertave për projektin "Furnizimi i bibliotekave me libra", me Nr. prokurimi: 623-23-197-1-2-1 dhe Nr. të brendshëm 623-23-001-1-2-1, të datës: 13.2.2023.

3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

4. Komisioni do ta fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.

5. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi me Nr. Prot. 02/169/23, i datës 14.2.2023.

6. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR
RAHOVEC ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 193 Nr. i faq/Br.str/No.pg 114
Data/Datum/Date 21 / 2 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, dhe nenit 4, paragrafi 4, dhe nenit 21, paragrafi 2, pika 2.1 dhe 2.2, i Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427, të datës 28.4.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

## VENDIM

1. **MIRATOHET** kërkesa e [redacted] fshati Petkoviq, Komuna e Rahovecit me Nr. Protokoli 311, të datës 30.1.2023, për ndihmë financiare prej [redacted] (katërqind e pesëdhjetë euro) për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit dhe blerjen e barërave për tretman të sëmundjes.

2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe përkujdesje Sociale.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

### *Arsyetim*

[redacted] vuan nga sëmundja e rëndë, e cila ka nevojë për tretman të vazhdueshëm për shërimin e saj. Shërimi i sëmundjes për të është tejet i kushtueshëm dhe ka kosto të lartë financiare të papërballueshme për të, pasi asnjë anëtar i familjes nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme.
Andaj, duke marrë parasysh gjendjen e rëndë shëndetësore dhe financiare të të lartpërmendurit, pasi shpenzimet e mjekimit dhe të blerjes së barërave për shërim, kanë kosto të lartë financiare, ai e ka të vështirë mbulimin e shpenzimeve elementare për jetesë dhe blerjen e barnave për shërimin e sëmundjes, kështu që është e domosdoshme ndihma për tejkalimin e kësaj gjendjeje.
Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Me vendim të njoftohen:***

- [redacted]
- ***Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,***
- ***Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**
**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR
RAHOVEC ORAHOVAC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 194 Nr. i faq/Br.str/No.pg 114
Data/Datum/Date 21 / 2 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 53 paragrafit 3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031, nenit 59 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, nenit 37 të Ligjit Nr. 05/L-068 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

## VENDIM

**Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me Nr. Prot. 02/136/23, i datës 9.2.2023, për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave**

1. Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi me Nr. Prot. 02/136/23, i datës 9.2.2023, për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave.

2. Pika 1.2. e vendimit bazik ndryshohet dhe plotësohet, si në vijim:

   **1.1.** Gërmia Gashi, anëtare.

3. Pikët e tjera të vendimit bazik me Nr. Prot. 02/136/23, i datës 9.2.2023, mbesin të pandryshuara.

4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Arsyetim***

Me vendimin 02/136/23, i datës 9.2.2023, është caktuar anëtare e komisionit për vlerësimin e ofertave për projektin "Furnizim me pako pedagogjike" me nr. të prokurimit 623-23-560-1-3-6 dhe nr. të brendshëm 623-23-013-1-3-6, të datës 8.2.2023.

Duke marrë parasysh se Liridon Gashi, i cili me vendimin bazik është caktuar anëtar i komisionit, gjendet në pushim vjetor, është i domosdoshëm zëvendësimi i tij dhe caktimi i znj. Gërmia Gashi si anëtare e komisionit.

Andaj, nga se u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Znj. Gërmia Gashi,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E RAHOVECIT
RAHOVEC
ORAHOVAC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 195 Nr. i faq/Br.str/No.pg 114
Data/Datum/Date 21 / 2 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 53 paragrafit 3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031, nenit 59 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, nenit 37 të Ligjit Nr. 05/L-068 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

# VENDIM

## Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me Nr. Prot. 02/184/23, i datës 16.2.2023, për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

1. Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi me Nr. Prot. 02/184/23, i datës 16.2.2023 për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave.

2. Pika 1.3 e vendimit bazik, ndryshohet dhe plotësohet, si në vijim:

   **1.3.** Gërmia Gashi, anëtare.

3. Pikat e tjera të vendimit bazik me Nr. Prot. 02/184/23, i datës 16.2.2023, mbesin të pandryshuara.

4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

### *Arsyetim*

Me vendimin 02/184/23, e datës 16.2.2023, është caktuar anëtare e komisionit për vlerësimin e ofertave për projektin "Mirëmbajtja e objekteve kulturore, monumenteve, fushave sportive dhe rekreative" me nr. të prokurimit 623-23-261-2-2-1 dhe nr. të brendshëm 623-23-006-2-2-1, të datës 15.2.2023.

Duke marrë parasysh se Liridon Gashi, i cili me vendimin bazik është caktuar anëtar i komisionit, gjendet në pushim vjetor, është i domosdoshëm zëvendësimi i tij dhe caktimi i znj. Gërmia Gashi si anëtare e komisionit.

Andaj, nga se u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Znj. Gërmia Gashi,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE
RAHOVEC
ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 199 Nr. i faq/Br.str/No.pg 114
Data/Datum/Date 21 / 2 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës *("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 21 të Ligjit Nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave *("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 21/2022")*, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës në Rahovec, merr këtë:

**VENDIM**
**Për caktimin e zyrtarit kontaktues për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhënave në Komunën e Rahovecit**

1. Z. Alban Gashi, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Zyrtar për barazi gjinore, në Drejtorinë për Administratë, në Komunën e Rahovecit, CAKTOHET:

   **1.1. Zyrtar kontaktues për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhënave në Komunën e Rahovecit.**

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarit kontaktues për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhënave në Komunën e Rahovecit, janë të caktuara Ligjin Nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset zyrtari kontaktues i caktuar dhe Drejtorët për Administratë.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***
- *Z. Alban Gashi,*
- *Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit,*
- *Njësisë së Personelit,*
- *Drejtorisë për Administratë, dhe*
- *Arkivit.*

**Smajl Latifi**
**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR
RAHOVEC ORAHOVAC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 200 Fq/Br.str/No.pg 114
Data/Datum/Date 23.1.23
RAHOVEC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale në Kosovë *("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 16 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 8/2019"), nenit 22, paragrafi 2.3 i Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe nenit 21 të Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë, nenit 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës: 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**V E N D I M**
**Për pagesën e shpërblimit të përvjetorit (jubile)**

1. **MIRATOHET si e bazuar** kërkesa e znjsh. Saranda Shala nga Rahoveci, me Nr. Prot. 170, të datës 23.1.2023, e sistemuar në punë dhe detyrat e punës Asistente në zyrën e turizmit, në Drejtorinë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm në Komunën e Rahovecit.
2. **LEJOHET** pagesa e shpërblimit jubilar të përvjetorit jubilar të marrëdhënies së pandërprerë të punës për 10 (dhjetë) vjet, për nëpunësin sipas pikës 1 të këtij vendimi.
3. **AUTORIZOHET** Drejtoria për Buxhet dhe Financa që, në harmoni me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, të kryejë pagesën në shumën prej 25% të pagës mesatare në shërbimin civil në emër të shpërblimit të përvjetorit (jubile) të parashtruesit të kërkesës, dhe mjetet të derdhen në xhirollogarinë e të lartcekurit.

***A r s y e t i m***

Më datë 23.1.2023, znjsh. Saranda Shala ka parashtruar kërkesë për kompensimin e pagesës jubilare për periudhën prej 8.6.2012 dhe në vazhdimësi deri në ditët e sotme si Asistente në zyrën e turizmit, në Drejtorinë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm në Komunën e Rahovecit.
Në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, në kohën e parashtrimit të kërkesës, kërkesa e znjsh. është miratuar dhe atë për pagesën e shpërblimit jubilar për 10 (dhjetë) vjet të punës së pandërprerë në shërbimin civil duke llogaritur nga data 13.5.2010 kur ka hyrë në fuqi Ligji Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, deri në datën e parashtrimit të kërkesës, kjo për arsye se ligji në fjalë nuk e parasheh pagesën për vitet e mëhershme (retroaktive).
Vendimi bazohet në nenin 22, paragrafi 2, pika 2.3, të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë i datës 13 maj 2010, si dhe nenit 21 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë të datës 24.12.2012, në të cilët parashihet pagesa e shpërblimit të përvjetorit (jubile).
Andaj, pas shqyrtimit të kërkesës, në bazë të dispozitave ligjore në fuqi, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.
**Këshillë Juridike**: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur, mund të parashtrojë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Znjsh. Saranda Shala nga Rahoveci,***
- ***Njësisë së Personelit,***
- ***Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**
**Kryetari i Komunës**

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 201 Nr. i faq/Br.str/No.pg 115
Data/Datum/Date 22/2/23
RAHOVEC – ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 21 dhe 26 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 11 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

**VENDIM**
**Për qasje në dokumente publike**

1. **Miratohet** e bazuar kërkesa me Nr. Prot. 02/185/23, e datës 16.2.2023, për qasje në dokumente publike nga z. Egzon Dahsyla – nga Birn/Kallxo.com dhe i ofrohet qasje e **plotë** në dokumente publike, dhe atë:

   1.1. Kushtet ndërtimore të lëshuara për lejen ndërtimore me numër 212, të datës 27.9.2021, të parcelës 7144-1;
   1.2. Dokumentacioni përcjellës për dhënien e kushteve ndërtimore.

2. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

***Arsyetim***

Në mbështetje të nenit 10, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (QDP), Komuna e Rahovecit ka pranuar kërkesën me Nr. Prot. 02/185/23, e datës 16.2.2023, për qasje në dokumente publike nga z. Egzon Dahsyla – nga Birn/Kallxo.com, për qasje në dokumente publike.
Pas shqyrtimit të kërkesës, z. Dahsyla, i ofrohet qasje e **plotë** në dokumente publike dhe atë: Kushtet ndërtimore të lëshuara për lejen ndërtimore me numër 212, të datës 27.9.2021, të parcelës 7144-1 dhe Dokumentacioni përcjellës për dhënien e kushteve ndërtimore, për përfituesin e lejes ndërtimore "Haxhijaha" Sh.P.K.
Kërkesa për Qasje në Dokumente Publike është pranuar në mënyrë elektronike.
Komuna e Rahovecit, pas shqyrtimit të kërkesës, si dhe pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë në Agjencionin për Informim dhe Privatësi brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e pranimit të tij.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Znj. Blerta Gashi, Zyrtare për shqyrtimin fillestar të QDP,***
- ***Z. Ardian Begaj – ekspert gjyqësor i ndërtimtarisë, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**
**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI / PREDSEDNIK / MAYOR
RAHOVEC ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 te Ligjit Nr.05/L-068, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 53, paragrafit 3, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Nr. 05/L-031, të datës 25.5.2016, nenit 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

# V E N D I M

## PLOTËSIMI DHE NDRYSHIMI I VENDIMIT ME NR. 145, I DATËS 9.2.2023

1. Me këtë vendim plotësohet - ndryshohet vendimi me Nr.154, i datës 9.2.2023, për formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave të projektit **"Blerja e dy autoambulancave "**, me Nr. prokurimi: 623-23-162-1-2-1 dhe Nr. të brendshëm: 6230-23–002–1–2–1, i datës 9.2.2023, në të cilin, të gjithë anëtarët e komisionit zëvendësohen me anëtarët e rinj, andaj komisioni do të jetë në këtë përbërje:

   **1.1. Mirsad Shala, kryesues;**
   **1.2. Dafina Gashi, anëtare;**
   **1.3. Egzon Thaqi, anëtar.**

2. Komisioni ka për detyrë ta bëjë vlerësimin e ofertave për projektin **"Blerja e dy autoambulancave "**, me Nr. prokurimi: 623-23-162-1-2-1 dhe Nr. të brendshëm: 6230-23–002–1–2–1, të datës 9.2.2023.

3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

4. Komisioni do ta fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.

5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Zyrës së Prokurimit,***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 203 Nr. i faq/Br.str/No.pg 115
Data/Datum/Date 22/2/23
RAHOVEC / ORAHOVAC

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
**Komuna e Rahovecit/ Opštine Orahovac/Municipality of Rahovec**

**Kryetari i komunës/Presednik Opstine/Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 204 Nr. i faq/Br.str/No.pg 115
Data/Datum/Date 22 / 2 /23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës, nr.03/L-040, nenit 49 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, Kërkesës së punëtores, të miratuar nga eprori i drejtpërdrejtë, si dhe nenit 92, të Statutit të komunës, Kryetari i komunës merr këtë:

## VENDIM
### Për dhënien e pushimit të lehonisë

1. **Znj. Elma Shehu** nga Rahoveci, e cila është në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe e sistemuar në punët dhe detyrat e punës: Zyrtare për gjeodezi në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, i aprovohet pushimi i lehonisë, në kohëzgjatje prej 12 muajsh, sipas dispozitave të përcaktuara me Ligjin e Punës Nr. 03/L-212.
2. E lartpërmendura, sipas Ligjit të Punës, 6 (gjashtë) muajt e parë të pushimit të lehonisë do të paguhet nga punëdhënësi me kompensim 70% të pagës bazë, nga data data 13.2.2023 deri më 13.8.2023, ndërsa, 3 (tre) muajt në vijim, pushimi i lehonisë paguhet nga Qeveria e Kosovës, me kompensim 50% të pagës mesatare në Kosovë, nga data 14.8.2023, deri 14.11.2023, ndërsa, 3 muajt e tjerë, do të jenë pa pagesë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset *Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.*

### Arsyetim

Punonjësja **Elma Shehu nga Rahoveci**, e cila është në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe e sistemuar në punët dhe detyrat e punës: Zyrtare për gjeodezi, në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, se nga data 13.2.2023 do të shkojë në pushim të lehonisë, sipas fletëlëshimit me Nr.181, të spitalit Regjional të Gjakovës "ISA GREZDA".
Duke pasur parasysh se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore që punëtorja ta realizojë pushimin e lehonisë, data e shkuarjes në pushim të lehonisë konfirmohet sipas fletëlëshimit të spitalit.
Nga sa u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshilla Juridike:** Nëpunësja ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, nga dita e marrjes së këtij vendimi.

**Vendimi u dërgohet:**

- **Znj. Elma Shehu,**
- **Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë**
- **Drejtorisë për Buxhet dhe Financa**
- **Dosjes së punëtores**
- **Njësisë së personelit.**

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK
RAHOVEC ORAHOVAC

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 205 Nr. i faq/Br.str/No.pg 115
Data/Datum/Date 27/1/23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM

**Për caktimin e komisionit për vlerësimin e dëmeve materiale dhe financiare në SHFMU "Mustafë Ibishi", paralelja e ndarë në Mrasor**

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e dëmeve materiale dhe financiare, të shkaktuara në oborrin e SHFMU "Mustafë Ibishi" , paralelja e ndarë në Mrasor, në përbërje prej:

   1.1. Jeton Krasniqi, kryesues,
   1.2. Diellza Çanta, anëtare,
   1.3. Antigona Krasniqi, anëtare.

2. Komisioni ka për detyrë ta bëjë vlerësimin e dëmeve materiale dhe financiare, të shkaktuara në objekt dhe jashtë objektit të SHFMU "Mustafë Ibishi", paralelja e ndarë në Mrasor, nga persona të papërgjegjshëm.

3. Obligohet komisioni që pas përfundimit të punës të hartojë raport me shkrim për Kryetarin e Komnës dhe Drejtorinë për Arsim në Komunën e Rahovecit.

4. Komisioni do ta fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfudojnë në afat deri më 28.2.2023 (e martë) .

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Anëtarët e komisionit,***
- ***Drejtoria për Arsim, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT
KRYETARI I KOMUNËS
RAHOVEC ORAHOVAC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 206 Nr.faq/Br.str./No.pg 115
Data/Datum/Date 2[illegible]
RAHOVEC / ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

---

Në mbështetje të nenit 13, nenit 17, pika k) dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008"), nenit 12, pika 12.1, 12.4 dhe 12.5 të Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare dhe nenit 57, paragrafi 1, pika 1.11, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, të datës 29.3.2017, dhe kërkesës së znj. Sevdije Berisha, me nr. prot. 121, të datës 17.1.2023, Kryetari i Komunës merr këtë:

**V E N D I M**

1. **Miratohet** kërkesa [illegible] Kruzi, me vendbanim në Rahovec, e cila jeton me dy fëmijë të mitur jetim, për strehim të përkohshëm emergjent (vazhdimi i strehimit) si rast në nevojë sociale në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh, respektivisht prej datës 1.2.2023, deri më 31.7.2023, te pronarja [illegible] rrugën Dëshmorët e Pashtrikut, pa nr. në Rahovec.

2. **Pagesa** në emër të qirasë, do të jetë në shumën prej [illegible] € **(njëqind e pesëdhjetë euro)** për çdo muaj.

3. **Autorizohet** drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në Komunën e Rahovecit që, sipas autorizimit ligjor, të lidhë marrëveshje për strehim të përkohshëm të familjes në nevojë sociale.

4. Përfitues nga pika 1 të këtij vendimi është zonja Sevdije Berisha, e lindur me 8.7.1967.

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

6. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***A r s y e t i m***

Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, pas pranimit të kërkesës nga pala, ka konstatuar se bëhet fjalë për familjen si kategori sociale me dy fëmijë të mitur, e që nuk kanë ku të strehohen, jetojnë me qira, ku të vetmin burim të të ardhurave e kanë nga Skema e Ndihmave Sociale, shumë e cila është e pamjaftueshme për t'i mbuluar të gjitha shpenzimet.
Mjetet për pagesë do të sigurohen nga kodi i shërbimeve sociale përmes DSHMS-së. Duke qenë se bëhet fjalë për rastin emergjent të strehimit të familjes, vendimi nuk është bazuar në procedurat ligjore që rregullojnë çështjet e prokurimit në Kosovë.

Andaj, nga se u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Z[illegible]***
- ***Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi,**
**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE
RAHOVEC ORAHOVAC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 207 N[illegible]/No pg 115
[illegible]atum/Date 2[illegible]
RAHOVEC / ORAHO[illegible]

Në mbështetje të nenit 13, nenit 17, pika k) dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008"), nenit 12, pika 12.1, 12.4 dhe 12.5, të Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare dhe nenit 57, paragrafi 1, pika 1.11, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, të datës 29.3.2017, dhe kërkesës së z. Liridon Isakaj, me nr. prot. 381, të datës 6.2.2023, Kryetari i Komunës merr këtë:

**V E N D I M**

1. **Miratohet** kërkesa e z. [illegible] Isakaj nga fshati Kaznik, Komuna e Rahovecit, me vendbanim në Rahovec, familja e të cilit përbëhet nga bashkëshortja dhe dy fëmijë të mitur, për strehim të përkohshëm emergjent (vazhdimi i strehimit), si rast në nevojë sociale, në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh, respektivisht prej datës 1.2.2023, deri më 31.7.2023, te pronari Naim Fazliu, në rrugën Xhelal Hajda -Toni pa nr., në Rahovec.

2. **Pagesa** në emër të qirasë, do të jetë në shumën prej [illegible] **(njëqind e pesëdhjetë euro)** për çdo muaj.

3. **Autorizohet** drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në Komunën e Rahovecit që, sipas autorizimit ligjor, të lidhë marrëveshje për strehim të përkohshëm të familjes në nevojë sociale.

4. Përfitues nga pika 1 të këtij vendimi është z. Liridon Isakaj, i lindur më 5.5.1993.

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

6. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***A r s y e t i m***

Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, pas pranimit të kërkesës nga pala, ka konstatuar se bëhet fjalë për familjen si kategori sociale me dy fëmijë të mitur, e që nuk kanë ku të strehohen, jetojnë me qira, ku të vetmin burim të të ardhurave i ka nga Skema e Ndihmave Sociale, shumë e cila është e pamjaftueshme për t'i mbuluar të gjitha shpenzimet.
Mjetet për pagesë, do të sigurohen nga kodi i shërbimeve sociale përmes DSHMS-së. Duke qenë se bëhet fjalë për rastin emergjent të strehimit të familjes, vendimi nuk është bazuar në procedurat ligjore që rregullojnë çështjet e prokurimit në Kosovë.

Andaj, nga se u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Z. [illegible]***
- ***Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS
RAHOVEC
ORAHOVAC

KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 108 Nr./No.pg 115
Data/Datum/Date [illegible]
RAHOVEC / ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Në mbështetje të nenit 13, nenit 17 pika k) dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008"), nenit 12, pika 12.1, 12.4 dhe 12.5 të Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare dhe nenit 57, paragrafi 1, pika 1.11, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, të datës 29.3.2017, dhe kërkesës së znj. Pranvera Shala, me nr. prot. 58, të datës 10.1.2023, Kryetari i Komunës merr këtë:

**VENDIM**

1. **Miratohet** kërkesa [illegible] me vendbanim në Rahovec, e cila jeton me bashkëshortin dhe me dy fëmijë të mitur (një vajzë dhe një djalë), për strehim të përkohshëm emergjent (vazhdimi i strehimit), si rast në nevojë sociale, në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh, respektivisht prej datës 1.2.2023, deri më 31.7.2023, te pronari [illegible], në Rahovec, të përfaqësuar nga Bashkim Hoxha.

2. **Pagesa** në emër të qirasë, do të jetë në shumën prej [illegible] **(njëqind e pesëdhjetë euro)** për çdo muaj.

3. **Autorizohet** drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesjes Sociale në Komunën e Rahovecit që, sipas autorizimit ligjor, të lidhë marrëveshje për strehim të përkohshëm të familjes në nevojë sociale.

4. Përfitues nga pika 1 të këtij vendimi është zonja [illegible], e lindur më 18.4.1979.

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

6. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Arsyetim***

Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, pas pranimit të kërkesës nga pala, ka konstatuar se bëhet fjalë për familjen si kategori sociale me dy fëmijë të mitur, e që nuk kanë ku të strehohen, jetojnë me qera, ku të vetmin burim të të ardhurave i kanë nga Skema e Ndihmave Sociale, shumë e cila është e pamjaftueshme për t'i mbuluar të gjitha shpenzimet.
Mjetet për pagesë do të sigurohen nga kodi i shërbimeve sociale përmes DSHMS-së. Duke qenë se bëhet fjalë për rastin emergjent të strehimit të familjes, vendimi nuk është bazuar në procedurat ligjore që rregullojnë çështjet e prokurimit në Kosovë.

Andaj, nga se u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Znj. [illegible],***
- ***Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 209 N... Nr./Br./No pg 115
Data/Datum/Date 17 ... 3
RAHOVEC / ORAHOVAC

# Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

---

Në mbështetje të nenit 13, nenit 17 pika k) dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008"), nenit 12, pika 12.1, 12.4 dhe 12.5 të Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare dhe nenit 57, paragrafi 1, pika 1.11, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, të datës 29.3.2017, dhe kërkesës së K/21/19, e mbijetuar e dhunës seksuale, të ndodhur gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës, me nr. prot. 397, të datës 7.2.2023, Kryetari i Komunës merr këtë:

## VENDIM

1. **Miratohet** kërkesa e [illegible], për strehim të përkohshëm emergjent (vazhdimi i strehimit), si rast në nevojë sociale, në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh, respektivisht prej datës 1.2.2023, deri më 31.7.2023, te pronari [illegible] në Rahovec.

2. **Pagesa** në emër të qirasë, do të jetë në shumën prej **150.00€ (njëqind e pesëdhjetë euro)** për çdo muaj.

3. **Autorizohet** drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesjes Sociale në Komunën e Rahovecit që, sipas autorizimit ligjor, të lidhë marrëveshje për strehim të përkohshëm të familjes në nevojë sociale.

4. Përfitues nga pika 1 dhe 2 të këtij vendimi është [illegible]).

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

6. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

## *Arsyetim*

Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, pas pranimit të kërkesës nga pala, ka pranuar kërkesën nga [illegible] për ndihmë për strehim pasi nga shtëpia në të cilën ajo ka jetuar, me kërkesë të pronarit, është detyruar të largohet.

Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, ka dalë në vendin e ngarjes dhe ka vizituar parashtruesen e kërkesës, me ç'rast ka konstatuar se është duke jetuar përkohësisht në një shtëpi në kushte të vështira, andaj, duke marrë parasysh nevojën për ndihmë të viktimës së dhunës seksuale të luftës, e cila është duke jetuar në kushte të vështira ekonomike dhe se [illegible] ka të pamundur mbulimin e shpenzimeve për jetesë dhe pagesën e qirasë, është e domosdoshme ndihma për tejkalimin e kësaj gjendjeje.

Mjetet për pagesë do të sigurohen nga kodi i shërbimeve sociale përmes DSHMS-së, duke qenë se bëhet fjalë për rastin emergjent të strehimit të familjes, vendimi nuk është bazuar në procedurat ligjore që rregullojnë çështjet e prokurimit në Kosovë.

Andaj, nga se u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,***
- ***[illegible],***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E RAHOVECIT
KRYETARI I KOMUNËS
RAHOVEC
ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")* dhe neneve 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, dhe kërkesës së Agjencionit Pyjor të Kosovës me Nr. Reference 69/2023, të datës 13.2.2023, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**VENDIM**
**Për caktimin e komisionit për identifikimin e pronave të uzurpuara**

1. **Caktohet** komisioni për identifikimin e pronave të uzurpuara në Komunën e Rahovecit, të cilat janë nën menaxhim të Agjencionit Pyjor të Kosovës, në këtë përbërje:

   **1.1.** Zamir Haxhibeqiri, kryesues,
   **1.2.** Miftar Krasniqi, anëtar,
   **1.3.** Milazim Elshani, anëtar.

2. Komisioni ka për detyrë që ta bëjë verifikimin, konstatimin dhe identifikimin e pronave të uzurpuara në Komunën e Rahovecit, të cilat janë nën menaxhimin e Agjencionit Pyjor të Kosovës.

3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në ligjet dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi në Republikën e Kosovës.

4. Obligohet komisioni që të hartojë raport me shkrim për Kryetarin e Komunës, Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural dhe Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, më së largu deri më 31 gusht 2023.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural,***
- ***Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**
**Kryetari i Komunës**

Republika e Kosovës/Republika Kosovo/Republic of Kosovo
Komuna Rahovec/Opština Orahovac
Kabineti i Kryetarit të Komunës/Kabinet Predsednika Opštine
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 210 Nr. i faq/Br.str/No.pg 115
Data/Datum/Date 23.2.23
RAHOVEC - ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 713 Nr. i faq/Br.str/No.pg 116
Data/Datum/Date 24/2/23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 40 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, nenit 16 të Rregullores (QRK) Nr. 07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publik, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, si dhe kërkesës së z. Agim Hoti me Nr. Prot. 455 të datës 9.2.2023, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

**V E N D I M**
**Për dhënien e pushimit nga puna pa pagesë**

1. **Miratohet** kërkesa për pushim pa pagesë e z. Agim Hoti nga fsh. Ratkoc Komuna e Rahovecit, me Nr. Personal të leternjoftimit 1007841503, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Zyrtar i lartë për punë profesionale për Kuvendin Komunal në Sektorin për punë të kuvendit dhe komiteteve, pranë Drejtorisë për Administratë në Komunën e Rahovecit, në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, respektivisht nga data 1.3.2023 deri me date 1.9.2023.

2. Të lartpërmendurit në pikën 1 të këtij vendimi i pushojnë të drejtat dhe detyrat nga marrëdhënia e punës, përveç të drejtës së rikthimit në pozitën e mëparshme pas kalimit të afatit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Obligohet Zyrtari/ja për paga në Komunën e Rahovecit që ta largoj nga lista e pagës z. Agim Hoti për periudhën e lartcekur.

4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Njësia e Personelit, Drejtoria për Administratë dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***A r s y e t i m***

z. Agim Hoti, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Zyrtar i lartë për punë profesionale për Kuvendin Komunal në Sektorin për punë të kuvendit dhe komiteteve, pranë Drejtorisë për Administratë në Komunën e Rahovecit, ka parashtruar kërkesë me Nr. Prot. 455 të datës 9.2.2023, me të cilën ka kërkuar pushim pa pagesë në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh, respektivisht nga data 1.3.2023 deri me date 1.9.2023.

Kërkesën i lartpërmenduri e ka parashtruar pasi, nëna e tij ka probleme shëndetësore dhe e njëjta me rekomandim të mjekëve specialist nuk është në gjendje që të tije e vetme dhe për këtë arsye i lartpërmenduri është i detyruar të kujdeset për të.

Duke marrë parasysh se i lartpërmenduri jeton vetëm me nënën e tij, dhe se është i obliguar që të përkujdeset për të, është e domosdoshme dhënia e pushimit mjekësor pa pagesë për z. Agim Hoti.

Gjatë kësaj periudhe, të lartpërmendurit i pushojnë të drejtat dhe detyrat e marrëdhënies së punës, përveç të drejtës së rikthimit në pozitën e mëparshme pas kalimit të afatit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

Pas administrimit të të gjitha provave, duke u bazuar në nenit 40 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, nenit 16 të Rregullores (QRK) Nr. 12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publik, është konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore që zyrtari publik ta shfrytëzoj pushimin pa pagesë, për përkujdesjen e shëndetit të nënës së tij.

Andaj, nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Z. Agim Hoti nga fsh. Ratkoc,***
- ***Drejtoria për Administratë,***
- ***Drejtoria për Buxhet dhe Financa,***
- ***Zyrtari/ja për paga,***
- ***Njësia e Personelit, dhe***
- ***Arkivi***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE / MAYOR
RAHOVEC
ORAHOVAC

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 214 Nr. i faq/Br.str/No.pg 116
Data/Datum/Date 24 / 2 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017. Kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM

## Për caktimin e komisionit për vlerësimin e dëmeve materiale dhe financiare në Palestrën e Sporteve "Mizahir Isma" në Rahovec

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e dëmeve materiale dhe financiare të shkaktuara në Palestrën e Sporteve "Mizahir Isma" në Rahovec me datë 19.02.2023, gjatë zhvillimit të garave të Kupës së Kosovës në basketboll "Final 8", në përbërje prej:

   **1.1** Arsim Kastrati, kryesues
   **1.2** Fidan Hoti, anëtar
   **1.3** Shpejtim Dulaku, anëtar

2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë vlerësimin e dëmeve materiale dhe financiare të shkaktuara në Palestrën e Sporteve "Mizahir Isma" në Rahovec me datë 19.02.2023, gjatë zhvillimit të garave të Kupës së Kosovës në basketboll "Final 8".

3. Obligohet komisioni që pas përfundimit të punës të hartoj raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Rahovecit.

4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojn më së largu me datë 28.02.2023.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Anëtarët e komisionit,***
- ***Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe***
- ***Arkivi***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR
II
RAHOVEC
ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 215 Nr. i faq/Br.str/No.pg 116
Data/Datum/Date 24/2/23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 8 të Rregullores MF-NR-04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005, i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**VENDIM**
**Për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të dhe shoqatat në fushën e rinisë dhe sportit mbi bazen e thirrjes publike**

1. **Caktohet** komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të dhe shoqatat në fushën e rinisë dhe sportit për vitin 2023, në këtë përbërje:
   **1.1** Qemajl Krasniqi, kryesues
   **1.2** Saranda Rama, anëtare
   **1.3** Egzon Thaqi, anëtar
   **1.4** Bajram Kabashi, anëtar (ekspert i jashtëm)
   **1.5** Mehreme Gërguri, anëtare (Përfaqësuese nga OJQ – ekspert i jashtëm)
   **1.6** Vlora Sylaj-Reshiti, anëtare rezervë

2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të dhe shoqatat në fushën e kulturës, mbi bazën e thirrjes publike me Nr. Prot. 367 të datës 3.2.2023 dhe në përputhje me Rregulloren MF-NR-04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.
3. Obligohet komisioni që të veprojë duke u bazuar në Rregulloren MF-NR-04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve dhe duke u bazuar thirjen publike me Nr. Prot. 367 të datës 3.2.2023.
4. Komisioni do të filloj punën me datën 24.2.2023 dhe ka mandat deri në përfundimin e procedures së shpalljes së përfituesve sipas Rregullores MF-NR-04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.
6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***DKRS-së, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**
**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / KRYETARI I KOMUNËS
RAHOVEC ORAHOVAC

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 216 Nr i faq/Br.str/No.pg 116
Data/Datum/Date 24/2/23
RAHOVEC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

## VENDIM
## Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: "Servisimi i pajisjeve mjekësore", me Nr. prokurimi: 623-23-491-2-2-1 dhe Nr. të brendshëm 623-23-011-2-2-1 të datës: 23.02.2023, në këtë përbërje:

   **1.1.** Etnik Popaj, kryesues
   **1.2.** Saranda Rama, anëtare
   **1.3.** Mimoza Ejupi, anëtare

2. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për projektin "Servisimi i pajisjeve mjekësore", me Nr. prokurimi: 623-23-491-2-2-1 dhe Nr. të brendshëm 623-23-011-2-2-1 të datës: 23.02.2023.

3. Obligohet komisioni që këto punë ti kryej duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.

5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS
II
RAHOVEC
ORAHOVAC

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 217 Nr. i faq/Br.str/No.pg 116
Data/Datum/Date 24/2/23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

**V E N D I M**
**Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave**

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: "Mbikëqyrja e investimeve kapitale në Komunën e Rahovecit", me Nr. prokurimi: 623-23-363-2-2-1 dhe Nr. të brendshëm 623-23-008-2-2-1, të datës: 21.2.2023, në këtë përbërje:

   **1.1.** Diellza Çanta, kryesuese,
   **1.2.** Egzon Thaqi, anëtar,
   **1.3.** Enise Dina, anëtare.

2. Komisioni ka për detyrë ta bëjë vlerësimin e ofertave për projektin "Mbikëqyrja e investimeve kapitale në Komunën e Rahovecit", me Nr. prokurimi: 623-23-363-2-2-1 dhe Nr. të brendshëm 623-23-008-2-2-1, të datës: 21.2.2023.

3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

4. Komisioni do ta fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.

5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT KRYETARI I KOMUNËS
RAHOVEC ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

***Komuna e Rahovecit***

*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*

**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

---

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 8 të Rregullores MF-NR-04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005, i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

## V E N D I M

**Për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të dhe shoqatat në fushën e kulturës mbi bazen e thirrjes publike**

1. **Caktohet** komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të dhe shoqatat në fushën e kulturës për vitin 2023, në këtë përbërje:
   - **1.1** Shedat Ukaj, kryesues
   - **1.2** Muharem Morina, anëtar
   - **1.3** Ardian Rama, anëtar
   - **1.4** Admir Mullabazi, anëtar (ekspert i jashtëm)
   - **1.5** Almedina Jaha, anëtare (Përfaqësuese nga OJQ – ekspert i jashtëm)
   - **1.6** Ramadan Sokoli, anëtare rezervë

2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të dhe shoqatat në fushën e kulturës, mbi bazën e thirrjes publike me Nr. Prot. 366 të datës 3.2.2023 dhe në përputhje me Rregulloren MF-NR-04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.
3. Obligohet komisioni që të veprojë duke u bazuar në Rregulloren MF-NR-04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve dhe duke u bazuar thirjen publike me Nr. Prot. 366 të datës 3.2.2023.
4. Komisioni do të filloj punën me datën 24.2.2023 dhe ka mandat deri në përfundimin e procedurës së shpalljes së përfituesve sipas Rregullores MF-NR-04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.
6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***DKRS-së, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT
KRYETARI I KOMUNËS
RAHOVEC
ORAHOVAC

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 218 Nr. i faq/Br.str/No.pg 116

Data/Datum/Date 24/2/23

RAHOVEC / ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

---

Në mbështetje të nenit 13, nenit 17 pika k) dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008"), nenit 12, pika 12.1, 12.4 dhe 12.5 të Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare dhe nenit 57, paragrafi 1, pika 1.11, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, të datës 29.3.2017, dhe kërkesës së z. Mentor Mahmuti, me nr. prot. 606, të datës 20.2.2023, Kryetari i Komunës merr këtë:

**VENDIM**

1. **Miratohet** kërkesa e z. [illegible]he, me vendbanim në Rahovec, i cili jeton me bashkëshorten dhe tre fëmijë të mitur, për strehim të përkohshëm emergjent (vazhdimi i strehimit), si rast në nevojë sociale, në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh, respektivisht nga data 1.2.2023, deri më 31.7.2023, te pronari Hilmi Zllanoga në Rahovec.

2. **Pagesa** në emër të qirasë do të jetë në shumën prej **100.00€ (njëqind euro)** për çdo muaj.

3. **Autorizohet** drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesjes Sociale në Komunën e Rahovecit që, sipas autorizimit ligjor, të lidhë marrëveshje për strehim të përkohshëm të familjes në nevojë sociale.

4. Përfitues nga pika 1dhe 2 të këtij vendimi është z. [illegible].

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

6. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Arsyetim***

Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, pas pranimit të kërkesës nga pala, ka konstatuar se bëhet fjalë për familjen si kategori sociale me tre fëmijë të mitur, e që nuk kanë ku të strehohen, jetojnë me qira, ku të vetmin burim të të ardhurave i kanë nga Skema e Ndihmave Sociale, shumë e cila është e pamjaftueshme për t'i mbuluar të gjitha shpenzimet.
Mjetet për pagesë do të sigurohen nga kodi i shërbimeve sociale përmes DSHMS-së, duke qenë se bëhet fjalë për rastin emergjent të strehimit të familjes, vendimi nuk është bazuar në procedurat ligjore që rregullojnë çështjet e prokurimit në Kosovë.

Andaj, nga se u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Vendimi u dërgohet:***

- *[illegible],*
- ***Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 219 Nr. i faq/Br.str/No.pg 116
Data/Datum/Date 24/2/23
RAHOVEC / ORAHOVAC

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT - KRYETARI I KOMUNËS
RAHOVEC ORAHOVAC